

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), si dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim i parashtruar nga DGL INTERNATIONAL (UK) LTD, me seli të regjistruar në Skver Sent Xhejms 11-12, kati i 3-të banesa 1, Londër SB1U4LB, Angli, i dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Baçovski Sinkoli Avokatë nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 02.02.2022, merr këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin DGL INTERNATIONAL (UK) LTD, me seli të regjistruar në Skver Sent Xhejms 11-12, kati i 3-të banesa 1, Londër SB1U 4LB, Angli do të fitojë kontrollin e vetëm të drejtpërdrejtë mbi DP JUB d.d., me seli në Dol Pri Lubjanë 28, 1262 Dol Pri Lubjanë, Slloveni, përmes shitblerjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, më 27.12.2021, i plotësuar më 05.01.2022, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim nga DGL INTERNATIONAL (UK) LTD, me seli të regjistruar në Skver Sent Xhejms 11-12, kati i 3-të banesa 1, Londër SB1U 4LB, Angli ku DGL INTERNATIONAL (UK) LTD ka për qëllim të fitojë kontrollin e vetëm të drejtpërdrejtë mbi DP JUB d.d., me seli në Dol Pri Lubjanë 28, 1262 Dol Pri Lubjanë, Slloveni përmes, shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

DGL INTERNATIONAL (UK) LTD është një kompani holding angleze, pjesë e Grupit Deluks dhe është në një kontroll të plotë të Nippon Paint Holdings Co, Ltd, një kompani japoneze e vlerësuar në bursën e Tokios, e pranishme në tregjet ndërkombëtare të Azisë, Amerikës së Veriut, Evropës, Amerikës së Jugut dhe Oqeanisë, aktive në industrinë e prodhimit dhe tregtisë së bojërave dhe lysterjeve, dhe shumë pak është e pranishme në tregjet e tjera.

As DGL INTERNATIONAL (UK) LTD dhe as ndonjë nga kompanitë në Grupin DGL nuk është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

DP JUB d.d. DP JUB dd është një kompani holding dhe kompania mëmë e Grupit JUB e cila merret me prodhimin dhe tregtimin e bojërave dekorative të brendshme dhe të jashtme, mbrojtjen dekorative për dru dhe metal, prodhimin e sistemeve të jashtme të izolimit të përbërë (ETICS) dhe kursimin e energjisë, prodhimin e llaçit dhe produkte për mbrojtjen e sipërfaqeve të betonit. Grupi JUB është i pranishëm në tregjet në të gjithë Evropën.

Grupi JUB është i pranishëm në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë së tij të varur:

- **Shoqëria për tregti dhe shërbime JUB SHPKNJP Shkup**, me seli në bul. Jane Sandanski nr. 79 A-3 Shkup, aktive në tregjet me shumicë të bojërave dekorative, llaç dhe tabelave ETC.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски